



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.11

Shtator 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 27. 08. 2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë)

1. Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

Ky projektligj parashikon heqjen e taksës së mbikalimeve ajrore nga ligji i sitemit të taksave, mbasi sipas Konventës ICAO dhe marrëveshjes së bërë me EUROCOL, të ardhurat që sigurohen nga "shërbimi navigacional i trafikut ajror" do të përdoren vetëm për përbalimin e shpenzimeve operacionale, për rritjen e sigurisë së fluturimit si dhe në kryerjen e investimeve me teknologji bashkëkohore, faktorë vendimtarë që lidhen drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë së avionëve dhe jetës së pasagjerëve.

(Vijon në faqen 2)

Nga Punimet e Kuvendit

Mesazh i Presidentit të Republikës Alfred Moisiu në Kuvend (mbajtur në seancë plenare më datë 13 shtator 2004).

Në mesazhin e Presidentit të Republikës ngrihen disa çështje të rëndësishme politike, që kanë të bëjnë me përmirësimin e punës nga forcat politike dhe nga drejtuesit e institucioneve shtetërore dhe që marrin një rëndësi të veçantë në periudhën në të cilën jetojmë, kur jemi në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe në procesin e përfshirjes në Marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit me Bashkimin Europian dhe të integritimit në Nato.

Presidenti i Republikës në këtë mesazh fton forcat politike që angazhimet e marra në marrëveshjet midis tyre t'i shdërrojnë në ligje, për t'i bërë ato të zbatueshme. Ai ve në dukje një mungesë angazhimi dhe përgjegjësie nga forcat politike për të zgjidhur me konsensus çështjet më të rëndësishme për vendin, gjë që u vu re në mënyrë të veçantë gjatë shqyrtimit në Kuvend të çështjes së pronave, asaj të kompensimit

(Vijon në faqen 4)

**Në këtë numër
do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e
Këshillit të Ministrave
faqe 1-3**

**2. Informacion mbi faqet
e internetit të
Institucioneve Qëndrore
faqe 1**

**4. Nga punimet e
Kuvendit për periudhën
1-15 shtator 2004
faqe 1, 4**

**5. Kalendari 2 javor i
Kuvendit,
20 - 30 korrik 2004
faqe 5-7**

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e
Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor
dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe
Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për miratimin e modelit të dokumentit të identitetit të shtetaseve shqiptarë.
2. Për përcaktimin e disa kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike.
3. Për fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të hidrocentralit të Lanabregasit, Tiranë, dhe për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të ofertave.
4. Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjitikës dhe Ministria e Ekonomisë, si organ shtetëror i autorizuar, dhe "Yilmaz Kablo", S.A.S, për uzinën e telave dhe të kabllove, Shkodër.
5. Për miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës së Republikës së Shqipërisë, dhe shoqërisë OMV (Albanian) Adriatic Sea Exploration GmbH dhe Lundrin Netherlands B.V, për lëshimin dhe prodhimin e hidrocentraleve në bllokun "Durrësi", në detin shqiptar.
6. Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 270, datë 25.04.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre".
7. Për vlerësimin e automjeteve të parkut të transportit të mineralit Bulqizë, dhe të automjeteve të Uzinës së Ferrokromit, Burrel.
8. Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë".
9. Për disa ndryshime në vendimin nr. 315, datë 24.04.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjes, shoqërive të institu-

cioneve shtetërore", të ndryshuar.

10. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Libanit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

11. Për një shtesë në vendimin nr. 322, datë 21.05.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre".

12. Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" për blerjen e një aparati të kompjuterizuar tomografie, për nevoja të shërbimit shëndetësor të nivelit terciar.

13. Për kalimin e përgjegjesisë së administrimit të disa parcelave pyjore, pjesë të ekonomisë pyjore Gjadër-Mnelë, Shkodër, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

14. Për miratimin në parim të marrëveshjes së granit Italian, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për rehabilitimin e sistemit të kullimit në zonat që u nënshtrohen përmbytjeve sezonale.

15. Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillimin Ndërkombëtar, për projektin e menaxhimit të burimeve ujore.

16. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ku-

vajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab, për projektin e rehabilitimit të ujitjes (faza III).

17. Për miratimin e kuotës së pranimit të studentëve në Akdeminë e Policisë "Arben Zylyftari", për vitin akademik 2004-2005.

18. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për financimin e Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë, 29 shtator – 5 tetor 2004.

19. Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave.

20. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Kiço Paphopuli.

21. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Vasil Anagnosti.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 10. 9. 2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozimin e projektligjit)

1. Për privatizimin e aksioneve, provë e Shtetit Shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare.

- Me këtë projektligj i hapet rruga fillimit të procedurave për shitjen e 40% të aksioneve që zotëron Shteti Shqiptar në Bankën Italo-Shqiptare.

Aksionet aktuale të Bankës, përveç Ministrisë së Financave me 40% të aksioneve, janë Kapitale me 40% dhe BERZH me 20% të aksioneve.

2. Për privatizimin e aksioneve, pronë e Shtetit Shqiptar, të Bankës së bashkuar të Shqipërisë.

- Projektligji i hap rrugë fillimit të procedurave për shitjen e 40% të aksioneve që zotëron Shteti Shqiptar. Përveç Ministrisë së Finan-

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

cave me 40% të aksioneve, aksionerë aktualë janë Shamil Bank me 20%, Banka Islamike e Zhvillimit me 15%, Alsaraha Holding me 10% dhe 15% investitorë të tjerë.

3. Për ratifikimin e Marrëveshjes së Konçesionit të Formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanës, Durrës.

- Dhënia me koncesion të formës "BOT", do të bëjë që ndërtimi i kësaj infrastrukture portuale të përfundojë shpejt dhe do të ndihmojë në nxitjen e investimeve.

4. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në shtojcën A të Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), "Për Rregullat Uniforme për Kontratën e Transportit Ndërkombëtar Hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve (CIV).

- Aderimi i rendit tonë në shtojcën A të kësaj Konvente do të pasurojë edhe më tej legjislacionin tonë në këtë fushë dhe zbatimi i këtij legjislacioni nga Hekurudha Shqiptare dhe ato të vendeve fqinjë do të ligjërojë lëvizjen e udhëtarëve dhe bagazheve, nga dhe nëpërmjet Shqipërisë.

5. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimin III/, Amendament i Konventës së Bazelit, "Lëvizjen Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre.

- Duke aderuar në këtë amendament, parandalohet rreziku për shëndetin dhe mjedisin nga lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme.

VENDIME të Këshillit të Ministrave.

1. Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integritimit European.

2. "Për miratimin e Satutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij.

3. Mbi procedurën për dhënien e lejes për importim, eksportim e prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

4. Për përcaktimin e masës së shpërblimit për medaljet që jepen personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Mbi një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.579, datë 8.12.1999 "Për kushtet dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar të ushtarëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në rastet e nxjerrjes së tyre në rezervë, lirim nga pensioni, i ndryshuar.

6. Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia.

7. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 15.2.2001 "Për Statusin e Spitaleve Universtitare".

8. Për ndryshime në Statusin e Fondit të Zhvillimit Shqiptar (FZSH).

Me këto ndryshime, shtohet përfaqësimi në Bordin Drejtues të FZSH-së edhe me një përfaqësues të Ministrisë së Integritimit dhe rritet niveli i përfaqësimit të Shoqatave të Bashkive të Shqipërisë nga 1 në 2 anëtarë.

9. Për shpronësimin për interes publik të disa pasurive të paluajshme, që preken nga rehabilitimi I segmentit rrugor Vorë-Fushë Krujë.

10. Për shpërndarjen e parakohshme të Këshillit të Komunës Dushk.

11. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shoqerive Anonime dhe ndërmarjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror.

12. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në Bashkinë e Leskovikut.

13. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në Bashkinë e Libohovës.

14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në Bashkinë e Burrelit.

15. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në Bashkinë e Krumës.

16. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore të Komunës Gjepalaj.

17. Për transferimin e mjediseve të Drejtorisë Rajonale të Doganës Pogradec, në pronësi të Bashkisë Pogradec.

18. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin "Përkrahje për ekonominë dhe punësimin rajonal në disa rrethe të Shqipërisë Veriore me strukturë të dobët, nëpërmjet masave për uljen e nivelit të varfërisë".

19. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Libanit për Shërbimet Ajrore.

20. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Libanit për Transportin detar.

21. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Autoritetin e konkurrencës.

22. Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomik-teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës.

23. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për shpërblimin e ekipit kombëtar të futbollit.

24. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Rregullimit të Territorit, për mbulimin e shpenzimeve për promovimin e veprimtarisë "Miss Globe International, 2004".

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 SHTATOR 2004

të ish-të përndjekurve politikë, si dhe çështjeve që kanë të bëjnë me reformën zgjedhore.

Një çështje tjetër që trajtohet në këtë mesazh ka të bëjë me përmirësimet që kërkohen të bëhen në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Atje theksohet se duhet të luftohet kundër mentalitetit të kontrollit politik të shtetit dhe të shkohet drejt vendosjes së shtetit ligjor mbi partitë. Ekzistenca e mentaliteteve të partisë-shtet, të bipolarizimit të jetës politiko-shoqërore, mungesa e kulturës ligjore, sipas mesazhit, ka dëmtuar funksionimin normal të shtetit, duke vendosur në krye të institucioneve militantë politikë, në vend të njerëzve profesionistë e besnikë ndaj ligjit, të çliruar nga diktati politik. Ajo gjithashtu ka cënuar zbatimin korrekt të statusit të nëpunësit civil, pasi janë vënë re raste të ndryshimit të njerëzve ekspertë e profesionistë me ndryshimin e qeverive, titullarëve të ministrive, institucioneve politike e atyre administrative.

Presidenti thekson se i duhet kushtuar më shumë vëmendje çështjes së zbatimit të Kushtetutës lidhur me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, pasi vihen re raste të imponimit të pushtetit legjislativ apo atij ekzekutiv mbi gjyqësorin ose institucionet e tjera kushtetuese, duke dëmtuar funksionimin e institucioneve. Gjithashtu, në mesazh kërkohet zbatim korrekt i Kushtetutës edhe në caktimin dhe njohjen e kompetencave të institucioneve, pasi vihen re raste kur institucioneve u jepen kompetenca shumë më të gjera se sa u takojnë ose ndodh e kundërta, akuzohen ato se kanë kapërcyer kompetencat, të cilat u takojnë me ligj.

Në mesazh theksohet se hyrja e Shqipërisë në NATO dhe në BE ka hasur në pengesa të tilla si konflikti i brendshëm politik, mungesa e stabilitetit dhe proceset zgjedhore të kontestuara. Rëndësi të veçantë i jepet kryerjes me sukses të reformës për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, për ta futur vendin në rrjedhat normale të zhvillimit dhe të integritimit.

Sipas mesazhit, politika duhet të jetë më shumë e lidhur me hallet e qytetarëve, të ofrojë programe zhvillimi, punësimi, edukimi dhe angazhimi konkret në mbrojtje të realizimit të interesave të zhvillimit dhe të integritimit, si dhe të të drejtave qytetare. Politikanët duhet të rrisin përgjegjësinë për miratimin e ligjeve me rëndësi të veçantë për qytetarët dhe vendin, si dhe të përpiqen që të gjejnë zgjidhjet më të mira ligjore.

Rëndësi e veçantë i jepet përgatitjes për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ku një rol të veçantë ka Komisioni i ngritur nga Kuvendi, i cili duhet të ofrojë zgjidhje të pranueshme gjerësisht dhe që të shdërrohen në ligj për të siguruar zgjedhje të lira, të barabarta dhe të ndershme. Nuk duhet të lejohet më që Shqipëria të penalizohet për shkak të paafësisë për të realizuar një proces zgjedhor të rregullt.

Në mesazh theksohet se vëmendje kryesore u duhet kushtuar jo vetëm respektimit të detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Asocim-Stabilizimit, por

edhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, veçanërisht forcimit të luftës kundër ekonomisë informale, krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ky proces, sipas mesazhit, duhet shoqëruar me thellimin e reformave në drejtësi, rritjen e rolit të Prokurorisë për të hetuar rastet e abuzimit me financat dhe me ligjin dhe rritjen e pavarësisë së veprimit dhe gjykimit të institucioneve të tjera mbikëqyrëse që garantojnë konkurrencën në treg dhe transparencën në zbatimin e ligjit. Gjithashtu, në mesazhin e Presidentit të Republikës vihen në dukje disa sektorë ose drejtime ku ka mangësi në zbatimin e ligjit dhe kërkohen përmirësime si në menaxhimin e fondeve publike, në ndarjen e të ardhurave, në planin e investimeve dhe në raportin midis pushtetit qendror e njëjësive vendore. Presidenti fton Kuvendin që ta rikonsiderojë edhe një herë çështjen e kompensimit të ish-të përndjekurve politikë. Drejtime të tjera ku kërkohet më tepër vëmendje, sipas mesazhit, janë lufta kundër varfërisë, nxitja e punësimit, liberalizimi i procedurave për zhvillimin e biznesit, zvogëlimi i diferencave gjeografike në zhvillimin ekonomik etj.

2. Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".Projektligji synon të plotësojë dhe të përmirësojë legjislacionin në fushën e luftës kundër drogës.Gjatë diskutimit të zhvilluar në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare një nga çështjet kryesore që u debatua kishte të bënte me nenin 1 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 9 të ligjit ekzistues. Ky ndryshim synon të ndalojë kultivimin e bimëve të gjinisë Cannabis, të cilat përmbajnë një përqindje tetrahidrokanabinoli (THC) mbi 0.1 për qind për prodhimin e drogës. Nga ana tjetër, kjo dispozitë lejon kultivimin e kërpit (Cannabissativa L.) për qëllime industriale për fibra dhe farëra, vetëm për varietetet, të cilat përmbajnë nën 0.1 për qind tetrahidrokanabinol. Importimi i farërave për këtë qëllim do të bëhet me leje të dhënë nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, sipas kërkesës që duhet të paraqesë personi i interesuar.

Disa deputetë, kryesisht përfaqësues të Komisionit të Bujqësisë dhe Ushqimit, u shprehën kundër amendimit për lejimin e kultivimit të kërpit për fibra dhe për farë, në kushtet kur mungojnë laboratorët e specializuar pranë strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit që të kontrollojnë përmbajtjen e tetrahidrokanabinolit. Në këto kushte, theksuan ata, ky amendim mund t'i hapë rrugë abuzimeve dhe mbjelljes së kanabisit për drogë.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash propozimin e projektligjit për këtë çështje.

Gjithashtu, Kuvendi miratoi edhe disa ndryshime të tjera që përmirësojnë përmbajtjen e projektligjit.

KALENDAR I

2 JAVOR (20-30 SHTATOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

**E Hënë, datë 20.9.2004,
Ora 17.00**

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Luigj Gjoka nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Ilirjan Berzani nga Ministri i Rendit Publik.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Ilir Bano nga Ministri i Rendit Publik.
5. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Gani Hoxha nga Ministri i Rendit Publik.

E Martë, datë 21.9.2004

E Mërkurë, datë 22.9.2004

Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve :

1. P/ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Athinës, "Për transportin e pasagjerëve dhe bagazheve të tyre në det", 1974 dhe Protokollin e vitit 1976, 1990 dhe 2002".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Jashtëm
-Komisioni i Industrisë**
2. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre".
-Komisioni i Ligjeve

**-Komisioni i Jashtëm
-Komisioni i Mbrojtjes**

3. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Transportit Ajror, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për shërbimet ajrore, ndërmjet dhe përtej territoreve respektive".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Jashtëm
-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit**

4. P/ligji "Për ratifikimin e Konventës 173, të **O r g a n i z a t ë s** Ndërkombëtare të Punës, mbrojtja e pretendimeve të punëtorëve në rast falimentimi të punëdhësit", 1992".
**-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)
-Komisioni i Jashtëm
-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale**

5. P/Ligji "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Rendit**

6. P/Ligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

7. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.8977, datë

12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës (e ka shqyrtuar)**

8. P/Ligji "Për legalizimin e zonave informale".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit
-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

9. P/Ligji "Për legalizimin e ndërtimeve në ngulimet e reja komunitare në qytete (paraqitur nga një grup deputetësh).
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit
-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

10. P/Ligji "Për Veterinarinë".
**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

11. P/Ligji "Mbi Dhomën e Mjekëve veterinarë dhe profesionin e mjekut veterinar", (paraqitur nga deputeti N.Alibali).

(Vijon në faqen 6)

KALENDAR I

2 JAVOR (5 - 15 KORRIK 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 5)

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Bujqësisë dhe
Ushqimit**

12. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (paraqitur nga një grup deputetësh).

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Mjeteve të
Informimit Publik
-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financës**

13. P/Ligji "Për shpalljen e ditës së kujtesës" (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

14. P/Ligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8975, datë 21.11.2002 "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm, si titull ekzekutiv".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Ekonomisë dhe
Financës (e ka
shqyrtuar)**

15. P/Ligji "Për sigurinë në Anije dhe Porte".

**-Komisioni i Rendit
Publik**

E Enjte, datë 23.9.2004, Ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Athinës, "Për transportin e pasagjerëve dhe bagazheve të tyre në

det", 1974 dhe Protokollet e vitit 1976, 1990 dhe 2002".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës nr.173, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, mbrojtja e pretendimeve të punëtorëve në rast falimentimi të punëdhënësit, 1992".
3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kartagenës për biosigurinë, të Konventës "Për larminë biologjike".
4. P/Ligji "Për shpalljen e ditës së kujtesës" (paraqitur nga një grup deputetësh).
5. P/Ligji "Për sigurinë në Anije dhe Porte".

PËR VOTIM:

1. P/Vendim "Për një ndryshim në Vendimin e Kuvendit nr. 132, datë 1.07.2004 "Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të VENECIAS për përmirësimin e Kodit Zgjedhor".

E Hënë, datë 27.9.2004, Ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Interpelancë me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, kërkuar nga deputetja Jozefina Topalli.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Jak Ndokaj, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Interpelancë me Ministrin e Pushtetit Vendor, kërkuar nga deputeti Bardhyl Londo.

E Martë, datë 28.9.2004

E Mërkurë, datë 29.9.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Jashtëm
-Komisioni i Rendit**

2. P/Ligji "Për pranimin nga Republika e Shqipërisë të Rezolutës A.724 (17), "Për ndryshimet e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare Detare dhe Aneksit të saj", 1991".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Jashtëm
-Komisioni i
Industrisë dhe
Telekomunikacionit**

3. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Jashtëm
-Komisioni i Rendit**

4. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Arsimit
dhe Kulturës**

5. P/Ligji "Për produktet e ndërtimit".

(Vijon në faqen 7)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 6)

**-Komisioni i Ligjeve
(e ka shqyrtuar)
-Komisioni i
Industrië dhe
Telekomunikacionit**

6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Shëndetësisë (e
ka shqyrtuar)**

7. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (paraqitur nga një grup deputetësh).

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Ekonomisë dhe
Financës**

8. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (paraqitur nga deputeti N.Alibali).

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Ekonomisë dhe
Financës**

9. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit, të vitit 2003".

-Raporti i KLSH "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2003".

**-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i
Ekonomisë dhe
Financës
-Komisionet e tjera**

10. Shqyrtimi i propozimeve për Këshillin Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.

-Komisioni i Ligjeve

**E Enjte, datë 30.9.2004,
ora 10.00**

-Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Ttraktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Transportit Ajror, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për shërbimet ajrore, ndërmjet dhe përtej territoreve respektive".

3. P/Ligji "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar"

4. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

5. P/Ligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8975, datë 21.11.2002 "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm, si titull ekzekutiv".

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org